



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**I.Numër: 400-01/37995, datë: 28 Maj 2024.**

Në bazë të nenit 11, nenit 12. paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 2 pika 2.3 të Ligjit Nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28 Maj 2024, në propozim të kryetarit të Komunës, merr këtë:

**VENDIM**

**Nr.21/2024**

**Për mbështetje financiare të Shoqatës së Zejtarëve, Hotelierëve dhe Afaristëve (SHZHA) me seli në Pejë me seli në Pejë**

1. **MIRATOHET** propozimi i kryetarit të Komunës së Pejës, për mbështetje financiare (Subvencionim) të Shoqatës së Zejtarëve, Hotelierëve dhe Afaristëve me seli në Pejë, në shumë prej **28,000.00€ (njëzet e tetë mijë euro)**, ky subvencionim bëhet me qëllim që të ruhen zejet e vjetra e që të mos shuhen.
2. Mjetet nga pika 1 e këtij konkluzioni do të participohen nga Buxheti Komunal Pejë i zyrës së Kryetarit, kodi Subvencione.
3. Të përzgjedhurit sipas shtojcës 1. Lista e dorzuar nga SHZHA, do të përfitojnë secili në vlerë prej **2,000.00€**, ku vlera totale e këtij subvencionimi do të jetë **28,000.00€**. Kjo vlerë e mjeteve do të transferohet në llogarin e Shoqatës së Zejtarëve, Hotelierëve dhe Afaristëve me seli në Pejë
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa të KK. Pejë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përkatëse për qeverisje lokale si dhe 7 (shtat) ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi ti dërgohet:**

MAPL,  
MFPT,  
Kryetarit të Komunës,  
DBF – ca,  
Arkiv.



## **Shtojca 1.**

Të përzgjedhurit sipas listës së dorëzuar nga SHZHA-së, janë:

- 1. Burim Gorani:** *Birskëpunues;*
- 2. Lulzim Bruqi:** *Mbathëtar;*
- 3. Jeton Shehu:** *Mbathëtar;*
- 4. Shefqet Bajrami:** *Farkatar;*
- 5. Parid Fetahu:** *Farkatar;*
- 6. Gëzim Muriqi:** *Farkatar;*
- 7. Nexhet Belegu:** *Saraç;*
- 8. Ymer Turjaka:** *Saraç;*
- 9. Arben Belegu:** *Saraç;*
- 10. Hysen Morina:** *Nallepunues;*
- 11. Bajram Bardhi:** *Leshlnuës;*
- 12. Afrim Lata:** *Qelepunues;*
- 13. Vllaznim Lata:** *Qelepunues;*
- 14. Avdullah Dula:** *Tabak.*